

Statistikat e Krimeve*

Tremujori i parë 2018

Tiranë, më 26 prill 2018: Në tremujorin e parë 2018, janë evidentuar gjithsej 7.909 vepra penale, duke shënuar një rritje me 5,5 %, krahasuar me tremujorin e parë 2017.


Numri i grupveprës vrasje me dashje të evidentuara, në tremujorin e parë 2018, është 12, rreth 4 vrasje më shumë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Për grupveprën penale Vrasje mbetur në tentativë, në këtë periudhë janë evidentuar 25 vepra, 8 më pak, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2017.

Numri i veprave penale të rënda kundër pasurisë, në këtë tremujor është 33, duke shënuar një rënie me 19 vepra, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2017. Kjo grupvepër përfshin veprat penale vjedhje me dhunë, vjedhje me armë dhe vjedhje me pasojë vdekjeje.

Në tremujorin e parë 2018 janë evidentuar 13 krime seksuale, rreth 16 më pak, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2017.

Fig. 1 Ndryshimi në përqindje sipas veprave, T1 - 2018 dhe T1 – 2017



*Përkufizimet e veprave penale gjenden në faqen nr. 5, Metodologjia

Për publikim 26/04/2018

Në tremujorin e parë 2018 janë evidentuar 428 vepra penale në fushën e drogës, duke shënuar një rënie me 6,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017. Këtu përfshihen veprat penale se prodhimi dhe shitja e narkotikëve, kultivimi i bimëve narkotike dhe trafikimi i narkotikëve. Tremujori i parë 2018 shënon vetëm 1 rast të kultivimit të bimëve narkotike, 5 më pak krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2017.

Në këtë periudhë janë evidentuar 58 vjedhje të automjeteve, me një rënie prej 32,6 %, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2017.

Numri i veprës penale të evidentuar për vjedhje lokale tregtie, në tremujorin e parë 2018, është 182, duke shënuar një rritje me 24,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Numri i veprës penale të evidentuar për vjedhje banese, në tremujorin e parë 2018, është 307, duke shënuar një rritje me 2,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në këtë periudhë janë evidentuar 20 vjedhje duke shpërdoruar detyrën, rreth 10 vjedhje më pak, krahasuar me të njëjtin tremujor të 2017.

Numri i grupveprës penale vjedhje mbetur në tentativë, në tremujorin e parë 2018, është 99, duke shënuar një rënie me 10 vepra, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Numri i veprës penale shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, në tremujorin e parë 2018 është 473, duke shënuar një rritje me 16,5%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab. 1 Vepra penale të evidentuara

Vepra penale	T1 - 2017	T2 - 2017	T3 - 2017	T4 - 2017	T1 - 2018	Ndryshimi në % (T1-2017 - T1-2018)
Vrasje me dashje	8	19	13	10	12	50,0
Vrasje mbetur në tentativë	33	35	39	22	25	-24,2
Vepra penale të rënda kundër pasurisë	52	34	36	42	33	-36,5
Krime seksuale	29	22	41	21	13	-55,2
Krime në fushën e drogës	458	595	613	454	428	-6,6
Vjedhje automjete	86	73	102	68	58	-32,6
Vjedhje lokale tregtie	146	124	89	133	182	24,7
Vjedhje banese	300	266	279	300	307	2,3
Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën	30	29	29	30	20	-33,3
Vjedhje mbetur në tentativë	109	125	90	93	99	-9,2
Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor	406	558	685	598	473	16,5
Vepra penale të tjera	5.838	6.513	7.935	6.707	6.259	7,2
Gjithsej	7.495	8.393	9.951	8.478	7.909	5,5

Autorët e veprave penale

Në tremujorin e parë 2018 janë evidentuar gjithsej 7.427 autorë të veprave penale, duke shënuar një rritje me 5,9 % krahasuar me tremujorin e parë të 2017.

Numri i autorëve për grupveprën vrasje me dashje, në këtë tremujor është 19, rreth 13 autorë më shumë të evidentuar, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndërkohë numërohen 38 autorë të evidentuar për grupveprën vrasje mbetur në tentativë, si në tremujorin e parë 2018 dhe 2017.

Numri i autorëve për vepra penale të rënda kundër pasurisë, në tremujorin e parë 2018, është 29, duke shënuar një rënie me 42 autorë, krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2017.

Në këtë periudhë janë evidentuar 13 autorë për grupveprën krime seksuale, duke shënuar një rënie me 17 autorë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Numri i autorëve për krime në fushën e drogës, në tremujorin e parë 2018, është 514, duke shënuar një rënie me 13,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Për veprën vjedhje të automjeteve, në këtë tremujor janë evidentuar 13 autorë, tre autorë më pak, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2017.

Në tremujorin e parë 2018 janë evidentuar 151 autorë për veprën vjedhje lokale tregtie, rreth 37 autorë më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Numri i autorëve për vjedhje banese, në tremujorin e parë 2018 është 155, duke shënuar një rënie me 2,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Për veprën vjedhje e kryer duke shpërdoruar detyrën, në këtë tremujor janë evidentuar 20 autorë, rreth 13 autorë më pak, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2017.

Numri i autorëve për grupveprën vjedhje mbetur në tentativë, në tremujorin e parë 2018 është 73, duke shënuar një rënie me 13 autorë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Për veprën shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor, në këtë tremujor janë evidentuar 453 autorë, rreth 62 autorë më shumë, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2017.

Tab. 2 Autorë të veprave penale

Vepra penale	T1 - 2017	T2 - 2017	T3 - 2017	T4 - 2017	T1 - 2018	Ndryshimi në % (T1-2017 - T1-2018)
Vrasje me dashje	6	17	15	10	19	216,7
Vrasje mbetur në tentativë	38	39	55	24	38	0,0
Vepra penale të rënda kundër pasurisë	71	33	46	42	29	-59,2
Krime seksuale	30	20	37	24	13	-56,7
Krime në fushën e drogës	591	702	674	574	514	-13,0
Vjedhje automjete	16	16	102	23	13	-18,8
Vjedhje lokale tregtie	114	80	117	70	151	32,5
Vjedhje banese	159	164	184	121	155	-2,5
Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën	33	34	34	29	20	-39,4
Vjedhje mbetur në tentativë	86	89	75	62	73	-15,1
Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor	391	553	687	581	453	15,9
Vepra penale të tjera	5.477	6.112	7.648	6.179	5.949	8,6
Gjithsej	7.012	7.859	9.674	7.739	7.427	5,9

Metodologjia

Statistikat e krimeve pasqyrojnë të dhëna mbi veprat penale të evidentuara dhe personat e dyshuar si autorë në kryerjen e një vepre penale.

Të dhënat mbi veprat penale të evidentuara i referohen artikujve të Kodit Penal dhe jo ngjarjes, pasi në një ngjarje mund të kemi më shumë se një vepër penale.

Të dhënat mbi autorët bazohen në persona të dyshuar në kryerjen e një vepre penale, jo në gjykime përfundimtare, të cilat janë në kompetencat e organeve të drejtësisë për të dhënë verdiktin.

Përkufizime:

Vepra penale: Veprat me të cilat cenohen, dëmtohen vlerat juridike të njeriut dhe të bashkësisë së caktuar quhen vepra penale apo me një term të përgjithshëm, kriminalitet. Ato ndahen në krime dhe kundërvajtje penale.

Autorë: Persona të cilët me veprimin ose mosveprimin e tyre lejojnë që të ndodhë një vepër penale, pra shkaktojnë pasojën e veprës penale. Autorët mbi 14 vjeç kanë përgjegjësi penale, ndërkohë fëmijët nën 14 vjeç janë të përjashtuar nga përgjegjësia penale.

Vrasje me dashje: Përfshin të gjitha ato vepra penale kundër jetës, të kryera me dashje si vrasje me dashje, vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër, vrasje me paramendim, vrasje për gjakmarrje, vrasje në rethana tjera cilësuese, vrasja e funksionarëve publike, vrasja e punonjësve të policisë së shtetit, vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare dhe vrasje e foshnjës.

Vrasje me dashje mbetur në tentativë: Përfshihen ato vepra penale kundër jetës, të kryera me dashje por mbetur në tentativë si vrasje në tentativë, tentativë vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër, tentativë vrasja me paramendim, tentativë vrasje në rethana të tjera cilësuese, tentativë vrasje e funksionarëve publike, tentativë vrasja e punonjësve të policisë së shtetit dhe tentativë vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare.

Vepra penale të rënda kundër pasurisë: Përfshihen ato vepra që synojnë vjedhjen e një personi, duke përdorur dhunë apo forcë si vjedhje me dhunë, vjedhje me armë dhe vjedhje me pasojë vdekjeje.

Krime seksuale: Përfshihen ato vepra të kundërligjshme që ndikojnë në sferën e sigurisë së lirisë seksuale dhe të zhvillimit normal të formimit seksual, si marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur, marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç, marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura, marrëdhëniet homoseksuale me dhunë me të rritur, marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t'u mbrojtur, marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me kërcënim me përdorimin e armës, marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën, marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari, marrëdhënie seksuale ose homoseksuale në vende publike, dhuna seksuale, vepra të turpshme dhe gacmimi seksual.

Vjedhje mbetur në tentativë: Përfshihen veprat penale si tentativë vjedhje banke, vjedhje me armë mbetur në tentativë, vjedhje me pasojë vdekje në tentativë, vjedhje me dhunë mbetur në tentativë dhe vjedhje të tjera në tentativë.

Krime në fushën e drogës: Përfshihen vepra si prodhimi dhe shitja e narkotikëve, kultivimi i bimëve narkotike, trafiku i narkotikëve.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Të dhënat mbi veprat penale të evidentuara dhe autorët janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.